



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 1489 Prot.

12.1

Patos, më 07/07/2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 06.07.2022 ora 11:00, në fshatin Verbas, Njësia Administrative Zharrëz ku zhvillohet dëgjesa publike **me temë**: Rikonstruksion dhe adaptim i kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore”, prishja e godinës pranë fushës sportive verbas që funksionon si qendër shëndetësore

Pjesëmarrës në këtë dëgjesë publike:

1. Kryetar të fshatrave të Njesisë Zharrëz
2. Përfaqësues të D.R.O.S.K.SH-së Vlorë
3. Përfaqësues të NJ.V.K.SH-së Fier
4. Banorë të zonës
5. Përfaqësues të Shoqërisë Civile
6. Koordinator i Konsultimit Publik
7. Përfaqësue të Bshkisë Patos

Takimi hapet nga Adminstatore e Njesisë znj. Polikseni Tupe

Polikseni Tupe – të nderuar pjesëmarrës ju falenderoj për kohën që na keni kushtuar kohë për të qenë prezent në këtë dëgjesë publike. Së bashku me përfaqësuesit e ekzekutivit me ne sot janë të pranishëm edhe përfaqësuesit e shëndetësisë dhe arsyeja se pse jemi këtu është kërkesa e Bashkisë Patos për informimin e banorëve të fshatit Verbas lidhur mbi investimin që bashkia kërkon të bëjë për rikonstruksion dhe adaptim i kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore. Gjiithsesi drejtori i shërbimeve do të na flasi më në detaje mbi këtë projekt dhe nëse keni pyetje apo paqartësi ne jemi të hapur për të marrë cdo sygjerim apo vërejtje tuajin. Fjala është për ju

Arben Manoku – faleminderit për prezantimin sic de jeni bërë me dije ky takim ka për qëllim informimin tuaj lidhur mbi projektin për rehabilitimin e kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore dhe prishjen e godinës pranë fushës sportive të fshatit e cila aktualisht funksionin si qendër shëndetësore. Ajo që ne kërkojmë është rikonstruksioni i godinës së “ ish kopshtit” dhe “Qendrës ambulatore”, godinë e cila është jashtë funksionimit të saj. Me rikonstruksionin e kësaj godine ne synojmë të sjellim një shërbim shëndetësor sa më cilësor për banorët e fshatit. Pas

transfermit të shërbimeve në ambientet e reja, edhe fusha e sportit do të nënshtrohet rikonstruksionit të ambienteve të saj dhe për rrjedhojë lind nevoja për prishjen e godinës ekzistuese. Ky është një investim i cili do të kryhet nga fondet e Bashkisë Patos por përfituesit real të këtij investimi jeni ju . Nëse keni pyetje apo komente unë jam i hapur t'ju përgjigjem cdo pyetje .

Arbër Arapi |Drejtorë i Nj.v.K.Sh-së Fier’| - cila është arsyeja e ndryshimit të këtij objekti?

Arben Manoku – ka qenë kërkesa e banorëve për të patur një qendër ambulatorie por edhe godina aktuale

Arbër Arapi – dhe sa është afati kohor për rikonstruksionin e objektit?

Arben Manoku – me afërsi një periudhë gjashtë deri në tetë muaj duje përfshirë të gjithë procesin nga prokurimi e deri në realizimin final të projektit.

Ladimir Hoxha – kjo godinë do të bëhet vetëm qendër shëndetësore apo edhe kopësht?

Arben Manoku – do të jetë vetëm qendër shëndetësore

Zini Shakaj | Përgjegjës i SDROSHKSH-së Vlorë|- Kjo godinë është pronë e bashkisë apo pronë private?

Arben Manoku – godina është pronë e inventarit të Bashkisë Patos

Gramoz Cepele – duket një investim i qartë por unë doja të dija kjo godinë do të jetë me termoizolim?

Arben Manoku – padiskutim që objekti do të ketë termoizolim.

Gramoz Cepele – po në lidhje me shkarkimin e ujrave të zeza si keni menduar ta zgjidhni pasi fshati nuk ka infrastrukturë KUZ

Arben Manoku – në objekt do të bëhen instalimet hidraulike dhe elektrike nga e para ndërsa lidhur mbi shkarkimin e ujrave të zeza kemi mendar që të jetë me gropë septike deri sa të ketë një rrjet të mirfilltë jo vetëm për qendrën shëndetësore por për të gjithë fshatin.

Mirela Komini- a është marrë miratimi nga banorët të cilët janë kufitarë me godinën pasi ata mund të ngrenë pretendimin se nuk e duan qendrën shëndetësore ngjitur me banesën e tyre?

Arben Manoku – ne prandaj po e realizojmë këtë dëgjese publike me qëllim marrjen e mendimit të banorëve lidhur mbi projektet që ne kërkojmë të realizojë. Interesimi për të qenë prezent në takime është i hapur. Gjithsesi edhe pse kjo është pronë e bashkisë ne përsëri kërkojmë të marrim mendimin e banorëve lidhur mbi të gjitha projektet tona por nuk kam detyrim ligjor ti kërkoj leje për zhvillimin e pronës sime.

Landimir Hoxha – lidhur mbi fushën sportive mund të më sqaroni se çfarë përfshihet në projekt?

Arben Manoku – investimi në fushën sportive Verbas është parashikuar për t'u investuar në projektin buxhetin afatmesëm

Flamur Muco – ne kërkojmë që kopshti të rregullohet i pari por edhe qendrën shëndetësore e duam në fshat pasi qendra aktuale nuk përmush kushtet e shërbimit

Arben Manoku – pikërisht ky është edhe qëllimi i këtij investimi, ofrimi i shërbimeve më cilësore për komunitetin

Plikseni Tupe – ndonjë pyetje tjetër? Mqse jo atëherë ky takim konsiderohet i mbyllur.

Konceptoi:
Koordinator Konsultimin Publik
Suzana Hysenaj



Sekretar Këshilli
Balil Balili

